



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 182 Prot.

Tiranë, më datë 18.03.2022

VENDIM
Nr. 53, datë 18.03.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale", Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 "Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.03.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Vlerësimit të Potencialit Arkeologjik i realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama, në kuadër të projektit "Rindërtim për shkak të dëmtimeve nga tërmeti i datës 26.11.2019, në objekt ekzistues 1 kat me çati" brënda kufirit të zonës Arkeologjike "A" të qytetit të Durrësit, me aplikues Endi Rexha, zhvillues Shpëtim Cani;
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Gjatë punimeve të gërmimit për projektin zhvillimor me objekt "Rindërtim për shkak të dëmtimeve nga tërmeti i datës 26.11.2019, në objekt ekzistues 1 kat me çati" brënda kufirit të zonës Arkeologjike "A" të qytetit të Durrësit, të kryhet ndjekja në mënyrë periodike e punimeve nga DRTK Tiranë, të cilët duhet të raportojnë pranë IKTK-së;
4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr.27, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarreveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

